



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 2958 / prot

Datë 15 :08.2022

Lënda: Kthim përgjigje shkresës suaj datë 25.07.2022 “Kërkesë për informacion”

**Znj.Era SHERIFAJ**

**(Rr.Elbasanit, Ndërtesa Park Gate, Kati 10, Apartamenti 71/73, PO Box; 2418/1, 1010)**

**TIRANË**

Në përgjigje të shkresës suaj datë 25.07.2022 “Kërkesë për informacion”, protokolluar me tonën nr.2958, datë 26.07.2022, Ju informojmë si më poshtë vijon:

1. Bashkia Gramsh në Buxhetin vjetor të vitit 2022 nuk ka ende të planifikuar një buxhet të dedikuar për rininë.
2. Punonjës të cilët i përkasin grupmoshës 18-29 vjec në bashkinë tonë janë 23 (njëzetë e tre), 11(njëmbëdhjetë) prej të cilëve janë femra dhe 12(dymbëdhjetë) meshkuj. Ndërsa një prej tyre është edhe në pozicione drejtuese(femër).
3. Përqindja e të rinjve, e grupmoshës 18-29 vjeç përllogaritet të jetë rreth 6.4%.
4. Bashkia Gramsh në bashkëpunim me Zyrën e Punës ju ofron të rinjve praktikant profesional 6- mujore pas përfundimit të shkollës.
5. Në Strukturën Organizative për vitin 2019 dhe në vijim, në Sektorin për Koordinimin Europian , Ndihmës së Huaj dhe Turizmit sektori ky, i cili meret me çështjet rinore, funksionon rregullisht specialisti i dedikuar për rininë.
6. Me mbështetjen e Organizatës “Lëvizjes Albania”, u implementua projekti “Fuqizimi i rinisë në Bashkinë Gramsh”, nga ku u ngrit Këshilli Rinor Gramsh, e para dhe e vetmja strukturë rinore në bashki e cila lobon për problematikat rinore. Në zbatim të ligjit nr.75 “Për rininë” është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, Vendimi nr.58, datë 01.08.2022 “Për Miratimin e Kritereve dhe Proçedurave të Përzgjedhjes së Antarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dheMënyrës së Organizimit dhe Funksionimit të tij”.
7. Këshilli Rinor ka ndëmarrë aktivitete të ndryshme sociale, kulturore, sportive, mjedisore etj.
8. Krahas këtyre aktiviteteve, gjatë dy viteve të fundit Bashkia Gramsh ka bashkëpunuar me disa organizata të ndryshme si :  
- **Shoqata e Kërkimeve Urbane dhe Klubi Ekologjik Elbasan** në kuadër të projektit “Qytetarë aktivë për monitorimin e ofrimit të shërbimeve publike vendore” ka bërë një anketim me të rinjtë e qytetit.

-Youth Center Perspektiva në kuadër të projektit “Be my voice: Say No to Discrimination”.

-Ëoman Center for Development and Culture Albania në kuadër të projektit : “Një qasje e integruar për të promovuar grate dhe të rinjtë Paqendërtues në Shqipëri.

-Ëorld Vision Albania me financimin Bashkimit European në bashkëpunim me Organizatën “Nisma” implementuan disa aktivitete rinore.

-Fondacioni Arsimor Shqiptar dhe Qendra STEPS organizuan trajnimin “Fuqizimi i rinisë, potencial për zhvillimin e komunitetit” i cili kishte synim fuqimizimin e të rinjve në Gramsh dhe angazhimin e tyre në veprime komunitare, nëpërmjet metodave të edukimit joformal.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

Konceptoi: J. Llapushi

Pranoi: A. Shuli

Miratoi: -//-

Konfirmoi: -//-

Afati i ruajtës: 10 vjet

**KRYETARI**

**Klodian TAÇE**

